



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK GRAMSH

Nr. 487/Prot.

Gramsh, më 7.01.2022

VENDIM

Nr. 38, datë 29.12.2021

“PËR

**DHËNIEN E PËLQIMIT PËR VENDOSJEN E BUSTIT “IBRAHIM  
BARDHYLIT (HOXHË BRASNIKU)”, NË URËN E SHËMRIZËS NJËSIA  
ADMINISTRATIVE PISHAJ, BASHKIA GRAMSH”**

Në mbështetje të nenit 2, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, neni 54, shkronja “l” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 143, datë 18.01.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë), të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Gramsh, të Qarku të Elbasanit, sipas raportit bashkangjitur, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Dhënie e pëlqimit për vendosjen e bustit “Ibrahim Bardhyli (Hoxhë Brasniku)”, në urën e shëmrizës, njësia Administrative Pishaj, Bashkia Gramsh sipas sipërfaqes dhe llojit të pasurisë me numrin përkatës të regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, drejtorinë vendore gramsh, në pronësi të Bashkisë Gramsh.
2. Përballimi i shpenzimeve për realizimin në vendosjen e bustit përballohen nga vetë familjarët.


3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6,të nenit 55,të ligjit nr.139/2015,“Për vetëqeverisjen vendore”,të ndryshuar.

**Sekretari Këshillit**

**Xhulia GJINI**

Konceptoi:Xh.GJINI  
Miratoi:G.LENA  
Pranoi:G.LENA



**KRYETARI KËSHILLIT**

**Greta LENA**

